



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 19.5.2022

**Lënda:** Parashtrime të Komisionerit Publik, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, mbi qartësimin e shkaqeve të ankimit kundër vendimit nr. 325, datë 14.12.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për subjektin e rivlerësimit znj. Rilinda Selimi

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në seancën e datës 28.4.2022, zhvilluar për gjykimin e çështjes që i përket ankimit që Komisioneri Publik ka ushtruar kundër vendimit me nr. 325/2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, gjyqtarja relatores e çështjes i drejtoi Komisionerit Publik disa pyetje sqaruese në lidhje me ankimin, për sa i përket cilësimeve ligjore të bëra në parashtrimet e paraqitura në këtë datë, në drejtim të nevojave për hetim që ato passjellin<sup>1</sup>.

Komisioneri Publik, në hartimin e parashtrimeve të datës 28.4.2022, është përpjekur të zbatojë jurisprudencën dhe ka mbajtur në konsideratë qëndrimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, ku trupi gjykues ka: [...] vlerësuar se investimi i tij në kontrollin e vendimeve të Komisionit, bëhet mbi bazën e shkaqeve konkrete të ankimit, të cilat ngrenë pretendime të argumentuara, qoftë në drejtim të nevojës për riçelje të hetimit nga ana e Kolegjit, të fakteve apo rrethanave të rëndësishme për zgjidhjen e çështjes në kuadër të konstatimit në mënyrë të plotë të gjendjes faktike [...]<sup>2</sup>.

Nisur nga sa më sipër, Komisioneri Publik, në parashtrimet e datës 28.4.2022, ka dhënë drejtimet konkrete të nevojës për çelje të hetimit, sigurisht pa u kufizuar vetëm në to, si dhe i qëndron të gjitha shkaqeve të ankimit të datës 12.2.2021, duke përfshirë referencat ligjore të cituara në ankim, të cilat legjitimojnë hetimin.

Lidhur me kërkesat për sqarim, referojmë sa vijon:

<sup>1</sup> Referuar seancës dhe procesverbalit të seancës gjyqësore vënë në dispozicion nga Kolegji, përmes shkresës nr. \*\*\* prot., datë \*\*.5.2022.

<sup>2</sup> Referohuni vendimit nr. (JR) 6/2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

1. Së pari, lidhur me paragrafin 18.7.6, të referuar në faqen 8 të ankimit të Komisionerit Publik<sup>3</sup>, krahasuar me paragrafin 6.5.6, në faqen 4 të parashtrimeve<sup>4</sup>, të cilat lidhen me trajtimin e pasurisë, Pika e karburantit, Vlorë

1.1 Kërkesa për sqarim i referohet faktit se në ankim flitet në referencë të nenit D të aneksit të Kushtetutës dhe neneve 61, pika 3 dhe 5, si dhe drejtimin në të cilin duhet të shkonte hetimi dhe analiza e Kolegjit, ndërsa në parashtrime është paraqitur e njëjta nevojë për të analizuar rrethanën faktike dhe ligjore, në drejtim të fshehjes, parashikuar nga neni D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës, dhe mungesë burimesh për subjektin e rivlerësimit, të ligjshme, për sa i përket krijimit të kursimeve në vlerën prej 10.000 euro.

1.2 Komisioneri Publik vëren se ankimi i paraqitur kundrejt vendimit nr. 325/2020, të Komisionit, është ushtruar, pasi referuar gjendjes së fakteve dhe provave në rastin konkret, në konsideratë dhe të Rekomandimit të ONM-së, ka vlerësuar se në gjendjen që janë aktet, nuk arrihet në konkluzionin se subjekti arrin një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë.

1.3 Komisioneri Publik, në ankim, duke argumentuar nevojat për hetim për kriterin e pasurisë, ka referuar nenin D të aneksit të Kushtetutës, pasi secili nga paragrafët e nenit D të aneksit të Kushtetutës normon një situatë të caktuar gjatë procesit të rivlerësimit të subjekteve<sup>5</sup>. Në përmbledhje, secila prej këtyre pjesëve të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, parashikon një element specifik dhe të pavarur nga të tjerët, “pavarësi”, e cila pasqyrohet në përcaktimet e masave disiplinore sipas nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

1.4 Në parashtrimet e datës 28.4.2022, Komisioneri Publik, bazuar në rrethana objektive, nisur dhe nga fakti se hetimi ka të bëjë me personat e tjerë të lidhur, pa cenuar kufijtë e proporcionalitetit, por duke legjitimuar dhe nevojat për hetim, ka referuar nenin D, pika 5 të aneksit të Kushtetutës, i cili lidhet jo vetëm me fshehjen e pasurisë, por dhe përpjekjen për ta paraqitur pasurinë ndryshe. Nëse nga analiza ligjore dhe faktike pas hetimit në Kolegj do të rezultonte se personat e tjerë të lidhur nuk kanë burime të ligjshme për të krijuar pasuritë e deklaruar nga subjekti, referimi i bazës ligjore të zbatueshme do të jetë në varësi të këtyre rezultateve.

2. Së dyti, lidhur me paragrafin 19.4, të referuar në faqen 11 të ankimit,<sup>6</sup> të paraqitur nga Komisioneri Publik, krahasuar me paragrafët 7.3 dhe në vijim të parashtrimeve, të cilët lidhen

---

<sup>3</sup> 18.7.6 Sa më sipër referuar, Komisioneri Publik, në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, çmon se duhet kryer një hetim i plotë lidhur me mundësinë e personin tjetër të lidhur, z. \*\*\*. \*\*\*, për të provuar burimin e ligjshëm të shumës 101.000 euro, të investuar në Pikën e karburantit, Vlorë. 18.9 Në përfundim, Komisioneri Publik, për pasurinë Pika e karburantit, Vlorë vlerëson se, pas administrimit të akteve, në funksion të një hetimi shterues administrativ, Kolegji mund të vlerësojë nëse ka rrethana që do të mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënte të cenueshëm vendimin e Komisionit lidhur me këtë pasuri, në zbatim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

<sup>4</sup> 6.5.6 Sa më sipër referuar, Komisioneri Publik, bazuar në Rekomandimin e ONM-së, të datës 28.1.2021, si dhe në jurisprudencën e Kolegjit, çmon se duhet rivlerësuar mundësia e personit tjetër të lidhur, z. \*\*\*. \*\*\*, për të mbuluar me të ardhura të ligjshme shumën 101.000 euro, të investuar në Pikën e karburantit, Vlorë, për të arritur në përfundimin nëse, gjatë kontrollit të kësaj pasurie, arrihet në një konkluzion në kuadër të nenit D, pika 5 e aneksit të Kushtetutës, në drejtim të tentativës së subjektit për të fshehur ose paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij.

<sup>5</sup> Referohuni vendimit nr. (JR) 19/2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

<sup>6</sup> 19.4 Komisioneri Publik, në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, dhe të jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, çmon se këto situata ligjore dhe faktike, parë në vlerësimin tërësor, mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënin të cenueshëm vendimin e Komisionit, në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, në zbatim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

*me administrimin e pasqyrave financiare të shoqërive tregtare, me të cilat subjekti dhe personat e lidhur/të tjerë të lidhur kanë marrëdhënie qiraje*<sup>7</sup>.

2.1 Kërkesa për sqarim i referohet faktit se në ankim është folur në drejtim të hetimit, në drejtim të cenimit të besimit të publikut, sipas nenit 61, pika 5, ndërsa në parashtrime kërkohen hetime për pasqyrat financiare të “\*\*\*\*” dhe “\*\*\*\* \*\*\*\*”. Sa më sipër, është kërkuar të sqarohet se në çfarë drejtimi e shikon Komisioneri Publik efektin që do të kishte ky hetim në vlerësimin e subjektit të rivlerësimit në këtë proces dhe në cilën dispozitë të Kushtetutës dhe të ligjit do ta shihnim këtë analizë, domethënë në çfarë konteksti dhe funksioni.

2.2 Komisioneri Publik, sa më lart parashtruar, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së<sup>8</sup> dhe të jurisprudencës së Kolegjit, ka qartësuar nevojat për hetim në drejtim të administrimit të pasqyrave financiare, pasi administrimi dhe analizimi i përmbajtjes së këtyre pasqyrave financiare do qartësonte natyrën ekonomiko-financiare të kontratave të qirasë dhe logjikën ekonomike në to.

2.3 Në vlerësim të situatave që do rezultojnë nga hetimi, mund të arrihet në përfundimin nëse subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur e kanë ekspozuar veten ndaj rrezikut që të bien nën ndikimin e palës tjetër, edhe për mënyrën e përmbushjes së detyrave të tij publike. Ky qëndrim është mbajtur dhe nga Kolegji në jurisprudencën e tij<sup>9</sup>, kur nga aktet e administruara kanë rezultuar rrethana të tilla në marrëdhëniet kontraktuale, që janë vlerësuar në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, në lidhje me nenin 61, pika 5 e të njëjtit ligj.

**3.** *Së treti, lidhur me paragrafin 20.4.3, të referuar në faqen 13 të ankimit,<sup>10</sup> të paraqitur nga Komisioneri Publik, krahasuar me paragrafin 8.6 të parashtrimeve<sup>11</sup>, të cilët lidhen me trajtimin e pasurisë, referuar në ankim si pasuria “Ndërtesa 3-katëshe në \*\*\*\*”*

3.1 Kërkesa për sqarim i referohet faktit se në ankim është folur në drejtim të hetimit, në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ndërsa në parashtrime kërkohet analizimi i ligjshmërisë së burimeve në zbatim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016.

3.2 Komisioneri Publik, në konsideratë të Rekomandimit të ONM-së, ku, ndër të tjera, për këtë pasuri i referohet shtrirjes së nevojave për hetim mbi ligjshmërinë e burimeve të vjehrrit të subjektit, pasi rezultati mund të jetë në drejtim të pasurisë së fshehur<sup>12</sup>, pasi ka argumentuar arsyet dhe rrethanat pse hetimi duhet të shtrihet mbi vjehrrin e subjektit, ka vlerësuar se rezultatet e këtij hetimi mund të çojnë në një vlerësim në drejtim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

<sup>7</sup> 7.5 Në përfundim, Komisioneri Publik, për të ardhurat e realizuara nga dhënia me qira e pasurisë *Pika e karburantit, Vlorë*, parashtron kërkesën për hetim si më poshtë: (1) Administrimin nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., të pasqyrave financiare për *Pikën e karburantit, Vlorë*, për vitet 2014-2015; (2) Administrimin nga shoqëria “\*\*\*\* \*\*\*\*” sh.p.k., të pasqyrave financiare për *Pikën e karburantit, Vlorë*, për vitet 2015-2018.

<sup>8</sup> Referohuni Rekomandimit, germa “a”, paragrafi i fundit, f. 5.

<sup>9</sup> Referohuni vendimit (JR) nr. 2/2020 të Kolegjit.

<sup>10</sup> **20.4.3** Në këto rrethana, Kolegji do të vlerësonte drejt nëse, në vlerësimin tërësor të procedurave, ngrihen dyshime në drejtim të interesave të fshehura të subjektit të rivlerësimit apo ndonjë paligjshmërie tjetër në këtë drejtim, që do të mund të ngarkonte me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënte të cenueshëm vendimin e Komisionit, në kuptim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

<sup>11</sup> **8.6** Sa më sipër, Komisioneri Publik, në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, ndryshe nga sa ka arsyetuar Komisioni në vendimin nr. 325/2020, kërkon nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, të cilësojë vjehrrin e subjektit si person tjetër të lidhur dhe, në zbatim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, të vlerësojë mbi mundësinë e këtij shtetasi për të justifikuar vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

<sup>12</sup> Referohuni f. 7, germa c (i), e Rekomandimit të ONM-së.

4. Së katërti, lidhur me paragrafin 21.9.7, të referuar në faqen 16 të ankimit,<sup>13</sup> të paraqitur nga Komisioneri Publik, krahasuar me shkaqet e paraqitura në faqen 9 dhe në vijim të parashtrimeve, lidhur me pasurinë e referuar në ankim si pasuria “Apartament, \*\*\*”.

4.1 Kërkesa për sqarim i referohet faktit se nëse në ankim është drejtuar vëmendja e Kolegjit drejt nenit 61, pika 3, për deklaram të pamjaftueshëm, dhe pika 5, kjo nuk ka gjetur zbatim njësoj në parashtrime, duke u fokusuar vetëm te neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

4.2 Komisioneri Publik vëren se në ankimin e paraqitur i është referuar faktit se pas administrimit të akteve të kërkuara mund të vlerësojë nëse ka rrethana që do të mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënin të cenueshëm vendimin e Komisionit, në zbatim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

4.3 Komisioneri Publik, në konsideratë dhe të jurisprudencës së Kolegjit, që ka sjellë në vëmendje se subjektet e rivlerësimit mbajnë përgjegjësi për saktësinë, vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve dhe gjendjes së pasurisë, deri në dorëzimin e Deklaratës “Vetting”<sup>14</sup>, në parashtrime ka identifikuar rrethanat specifike pse do të ishte e arsyeshme analiza e kësaj pasurie nga Kolegji, në kushtet kur në gjendjen që janë aktet, krijohet dyshimi për deklaram të pasaktë dhe të pavërtetë. Rezultati i hetimit nga analiza e kësaj pasurie, të deklaruar pas Deklaratës “Vetting”, mund të vlerësohet më së paku në drejtim të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

5. Së pesti, lidhur me paragrafin 22.2.4 dhe në vijim, të referuar në faqen 17 të ankimit,<sup>15</sup> të paraqitur nga Komisioneri Publik, krahasuar me shkaqet e paraqitura në prg. 11.5, në faqen 11 të parashtrimeve<sup>16</sup>, lidhur me pasurinë e referuar në ankim si pasuria “Automjet BMW”.

5.1 Kërkesa për sqarim për këto dy paragrafë i referohet faktit se në ankim Komisioneri Publik, në nevojat për hetim, është ndalur vetëm te çmimi, burimi i krijimit dhe kontrata, ndërsa në parashtrime ka kërkuar të administrojë dhe informacion mbi policën e sigurimit për automjetin, informacion për kontratën e shitblerjes, çmimin dhe palët.

5.2 Ashtu sikurse është parashtruar dhe në ankimin e paraqitur dhe në parashtrimet e datës 28.4.2022, Komisioneri Publik ka ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 325/2020, të Komisionit, pasi ka vlerësuar se nga aktet e administruara, të vëna në dispozicion Komisionerit Publik, nuk krijohet bindja se subjekti arrin nivel të besueshëm për konfirmimin në detyrë.

5.3 Sa më sipër, Komisioneri Publik, në parashtrimet e datës 28.4.2022, ka saktësuar nevojën për të administruar policën e sigurimit të këtij automjeti, policë së cilës i referohet dhe

<sup>13</sup> 21.9.7 Pas administrimit të akteve në funksion të një hetimi shterues administrativ, Kolegji mund të vlerësojë nëse ka rrethana që do të mund të ngarkonin me përgjegjësi subjektin e rivlerësimit dhe të bënin të cenueshëm vendimin e Komisionit lidhur me këtë pasuri sipas përkufizimit të “pasurisë”, dhënë nga neni 3, pika 11 e ligjit nr. 84/2016, në zbatim të nenit D, të aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016.

<sup>14</sup> Referohuni vendimit (JR) nr. 8/2021, prg. 26.3 i vendimit të Kolegjit.

<sup>15</sup> 22.2.4 Komisioneri Publik, në vlerësim dhe të Rekomandimit të ONM-së, për sa kohë mjeti nuk figuron i regjistruar në DPSHTRR dhe nga polica e sigurimit rezulton se në cilësinë e pronarit të automjetit është kunati i subjektit të rivlerësimit, z. \*\*\*, \*\*\*, vlerëson se Komisioni duhej të hetonte më tej dhe të qartësonte disa situata, në drejtim të: (1) çmimit të blerjes së pasurisë, automjetit tip “BMW 535 D”, me targë \*\*\*; (2) burimit të ligjshëm të blerjes; (3) kontratës së shitblerjes dhe palëve në kontratë.

<sup>16</sup> 11.5 Si rezultat, Komisioneri Publik parashtron kërkesën për hetim si më poshtë: (1) të administrojë informacionin lidhur me policën e sigurimit për këtë automjet, duke iu drejtuar AMF-së; (2) të administrojë informacionin mbi kontratën e shitblerjes, çmimin dhe palët në kontratë.

Rekomandimi i ONM-së, në f. 7 të tij, germa “e”, ku, ndër të tjera, *referon se, bazuar në policën e sigurimit të automjetit, emri i kumatit të subjektit të rivlerësimit, rezulton në cilësinë e pronarit, ndërkohë që bazuar në DPSHTRR, kjo makinë nuk figuronte e regjistruar*. Kjo policë nuk gjendet e administruar në dosjen e Komisionit, përcjellë Komisionerit Publik, së bashku me vendimin nr. 325/2020.

**6.** Komisioneri Publik, lidhur me kërkesën për sqarim mbi kërkimin e informacionit që do të përjashtonte mundësinë e konfliktit të interesit nga ana e subjektit, për disa gjykata ku ka shërbyer si gjyqtare, vëren se moscitimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, ka qenë një gabim në shkrim, pasi nga aktet rezulton se subjekti ka ushtruar detyrën si gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Librazhd, pas përfundimit të studimeve, në datën \*\*.10.2001 deri më \*\*.10.2003, kur është transferuar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**